



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare
Ministarstvo za Rad, Porodicu i Vrednosti Oslobodilačkog Borbe
Ministry of Labour, Family and Values of the Liberation War

PYETJET DHE PËRGJIGJJET RRETH THIRRJES PUBLIKE TË DATËS 10/04/2026

Pyetje:

1. A mundemi me aplikua në këtë thirrje nëse menaxheri potencial i projektit posedon licencën e lartcekur apo duhet patjetër që ta ketë këtë licence edhe OJQ-ja?

Përgjigje:

- Në kuadër të thirrjes publike të datës 10.4.2026 për mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve të licencuara në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, organizatat jo-qeveritare të licencuara në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet e tyre për ofrimin e shërbimeve sociale. OJQ-ja duhet ta ketë licencë për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare nga ministria përkatëse.

Pyetje:

2. Staf i përfshirë në projekt propozim a duhet gjithsesi me qenë dikush i licencuar për shërbime sociale?

Përgjigje:

- Staf i profesional i përfshirë në projekt propozim për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare duhet të jetë i licencuar nga ministria përkatëse për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare.

Pyetje:

3. Organizata jonë nuk posedon licencë për ofrimin e shërbimeve sociale, mirëpo bashkëpunon me një klinikë private të licencuar. A është e lejuar që si OJQ të aplikojmë dhe implementojmë projektin në bashkëpunim me këtë klinikë, ku ofrimi i shërbimeve realizohet nga ana e saj dhe ndërmjetësohet nga ana jonë?

Përgjigje:

- Organizatat joqeveritare mund të aplikojnë për mbështetje financiare të projekteve të tyre në kuadër të partneritetit me OJQ të tjera. Në rast të aplikimit në partneritet, duhet të dëshmojnë licencat nga ministria përkatëse në fusha e shërbimeve sociale dhe familjare. Organizatat jo-qeveritare të licencuara në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet e tyre për ofrimin e shërbimeve sociale. Në këtë rast, OJQ-ja duhet të jetë licencuar nga ministria përkatëse për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare.

Pyetje:

4. A janë këto forma të njëjta me ato të përdorura vitin e kaluar, apo ka ndryshime që duhet të kemi parasysh gjatë aplikimit?

Përgjigje:

- Referojuni thirrjes publike të datës 10.04.2026 për mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve të licencuara në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare si dhe udhëzuesit për aplikantët. Dokumentacioni është publikuar në faqen zyrtare të ministrisë (MPFVLC) e cila specifikon dhe qartëson mënyrën e aplikimit dhe kriteret për aplikuesit.

Pyetje:

5. Do të dëshironim të dinim nëse ekziston mundësia që të aplikojmë në projekte edhe gjatë kësaj periudhe, pra derisa jemi në proces të licencimit, apo nëse aplikimi lejohet vetëm pasi të kemi marrë zyrtarisht licencën?

Përgjigje:

- Në kuadër të thirrjes publike të datës 10.4.2026 për mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve të licencuara në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, organizatat jo-qeveritare të licencuara në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet e tyre për ofrimin e shërbimeve sociale. OJQ-ja duhet të ketë licencë për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare nga ministria përkatëse.